



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:900386

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513244

CAP.nr.356/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESCO), me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, Nr.5, Ndërtesa e Elektro Kosovës, Kati i -VII-, kundër debitorit S.Sh nga fshati K, Komuna e D., për shkak të borxhit nga shërbimi i furnizimit me energji elektrike, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit PPP.nr.2061/19 të datës 14.08.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESCO), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi PPP.nr.2061/19 datë 14.08.2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2061/19 të datës 14.08.2020, ka vendosur në pikën -I- të dispozitivit dhe e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Syle Shala nga fshati Kleçkë Komuna e Drenasit i datës 25.11.2019, kundër Urdhrit Përmbartimorë të Përmbartuesit Driton Govori P.nr.599/19 date 29.10.2019, sa i përket shumës së borxhit 333.00 euro, për shkak të pagesave të kryera, dhe ne këtë pjesë Urdhri përmbartimorë shfuqizohet. Në pikën -II-, Refuzohet si pjesërisht i pabazuar prapësimi i debitorit S.Sh nga fshati K Komuna e D.i datës 25.11.2019, kundër urdhrit përmbartimorë të përmbartuesit Driton Govori P.nr.599/19 dare 29.10.2019, sa i përket shumes së borxhit 231.78 euro dhe ne këtë pjese Urdhri përmbartimore mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të aprovoj si të bazuar ankesën e kreditorit dhe të ndryshoj aktvendimin e atakuar, duke lënë në fuqi urdhrin për përmbarim të përmbaruesit P.nr.599/21 të datës 14.02.2019, ose të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për konsumimin e energjisë elektrike, lidhur me borxhin, në vlerë prej 503.20 euro, për periudhën kohore nga data 25.09.2018 e deri me datë 12.10.2019. Përmbaruesi Privat, e ka lejuar përmbarimin e kërkuar me urdhrin përmbarimor P.nr.599/19 të datës 29.10.2019, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 25.11.2019, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 27.11.2019.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se: *“përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Dokumenti i

besueshëm, është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është ekstrakti i verifikuar nga libri afarist, DPR-90076069. Ekstrakti është i përshtatshëm për përmbardim ngase është i dorëzuar në origjinal, në të është cekur kreditori dhe debitori, objekti dhe lloji, andaj nga kjo rezulton se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në aktvendimin e ankimuar kur ka vlerësuar se për gjatë periudhës kontestuese debitori ka bërë pagesa në shumën prej 333.00 euro, për sa edhe është shfuqizuar urdhri përmbardimor sepse vet kreditori me rastin e bërjes së pagesave nga e debitorit nuk e definon në ekstrakt se për cilin muaj respektivisht cila faturë është paguar nga debitori me rastin e pagesave të kohë paskohshme, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr.356/2023 me datë 27.03.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevc